# FLETORJA ZYRTARE

## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2023 – Numri: 178

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E martë, 12 dhjetor 2023**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 657, datë 6.12.2023 | Për emërimin në detyrë të një anëtari të bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile...................................... | 21557 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 6.12.2023 | Për autorizimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për negocimin dhe nënshkrimin e rinovimit të marrëveshjes së partneritetit strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë "*Microsoft Corporation*" ................................................................................ | 21557 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 6.12.2023 | Për një ndryshim në vendimin nr. 141, datë 22.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", të ndryshuar.................................................................................................. | 21557 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 236, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese", të ndryshuar ................................................................... | 21558 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 661, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, dhe caktimin e Bashkisë Shijak si njësi zbatuese", të ndryshuar .................................................................................................................... | 21558 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 359, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, dhe caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese" ........................................................................................ | 21559 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 663, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 360, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, dhe caktimin e Bashkisë Rrogozhinë si njësi zbatuese", të ndryshuar......... | 21559 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 664, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 391, datë 9.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për sistemimin e hapësirave publike brenda zonës së re për zhvillim, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, dhe caktimin si njësi zbatuese të Bashkisë Kamzë" .......... | 21560 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 491, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit të qendrave shëndetësore në Bashkinë Kurbin, dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese" .......... | 21560 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 499, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), Njësia Administrative Laç dhe Mamurras, Bashkia Kurbin, dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese" .......... | 21561 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 667, datë 6.12.2023 | Për një ndryshim në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall", të ndryshuar | 21561 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 668, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 90, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të godinës kopsht/çerdhe në zonën e re për zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese", të ndryshuar.......... | 21562 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 89, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali 'Shenjta Mari' dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese" , të ndryshuar.......... | 21562 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 87, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit/riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë", të ndryshuar | 21563 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 88, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të tri objekteve arsimore në Bashkinë Kurbin dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese".......... | 21563 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 27, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë dhe Kurbin", të ndryshuar.......... | 21564 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona '5 maji', dhe Njësinë Administrative 6, zona 'Kombinat', Bashkia Tiranë", të ndryshuar .......... | 21565 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 715, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit e të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë", të ndryshuar................................................................................ | 21565 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 980, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit", të ndryshuar.......................................................................... | 21566 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 770, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare 'Demokracia', Valias i Ri, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese", të ndryshuar.................................................... | 21566 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 428, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kurbin dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese", të ndryshuar............... | 21567 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 500, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të një objekti arsimor në Bashkinë Vorë dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese"............................................ | 21567 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 679, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 490, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit dhe riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë"........................ | 21568 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 680, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 714, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare 'Halit Coka', Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese" ........................................................................................... | 21569 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 239, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kavajë"............................................ | 21569 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 255, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës"................................................... | 21570 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar", të ndryshuar................... | 21570 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 684, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 122, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të shkollës 9-vjeçare 'Picar', Bashkia Vorë, dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese", të ndryshuar................................................................................ | 21571 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 169, datë 17.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve të ish-Repartit 'RENEA', Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si njësi zbatuese" ................................................................................... | 21571 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave", të ndryshuar....................................... | 21572 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 206, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të stacionit të zjarrfikëses dhe të godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, dhe caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese"........... | 21573 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 688, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore", të ndryshuar .............................. | 21573 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 689, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese", të ndryshuar................................................................................................ | 21574 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë", të ndryshuar.......................................................................... | 21574 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 166, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese", të ndryshuar.................................................................... | 21575 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 180, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në Bashkinë Krujë"..................... | 21576 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 200, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Mirditë dhe Kamzë, dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese", të ndryshuar................ | 21576 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 215, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Lezhë e Kurbin, dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese", të ndryshuar................. | 21577 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 6.12.2023 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 125, datë 3.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve 'Rehabilitimi i lumit Gjanicë', 'Rikonceptimi i qendrës së qytetit' dhe 'Ndërtimi i Stadiumit të Lojërave me Dorë', Fier".......... | 21577 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 6.12.2023 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 820, datë 21.10.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurës, të kategorive, të kushteve, të kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata në veprimtarinë studimore projektuese në fushën minerare"..................... | 21580 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 6.12.2023 | Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për lëndët e para (*Eit RawMaterials Regional Inovation Center*)................ | 21581 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 698, datë 6.12.2023 | Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar........................................................................ | 21585 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 699, datë 6.12.2023 | Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar........................................................................................ | 21585 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 6.12.2023 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 569, datë 6.10.2023, "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar të vitit 2023 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Samitit të Procesit të Berlinit të datës 16 tetor 2023"........................................................................................................ | 21592 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 702, datë 6.12.2023 | Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2024, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)........................................... | 21592 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 6.12.2023 | Për mbylljen e veprimtarisë së Kolegjit Universitar "Pavarësia"......... | 21593 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 6.12.2023 | Për financimin e veprimtarisë së fondacionit "*Durrah City Football Academy*" për vitin 2023............................................................................ | 21593 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 6.12.2023 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e projektit 'Ekipet sportive në shkolla', në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)".................................................. | 21594 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 6.12.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", të ndryshuar........................................................................................ | 21594 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 6.12.2023 | Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Provës ........................................ | 21628 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 6.12.2023 | Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Kukësit | 21628 |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 25, datë 1.12.2023 | Për pilotimin e skemës së mësuesit në dispozicion dhe detyrave të tij në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.................. | 21629 |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit 26, datë 5.12.2023 | Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 30, datë 4.11.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”................................ | 21633 |

**VENDIM**
**Nr. 657, datë 6.12.2023**

## PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË ANËTARI TË BORDIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 10093, datë 9.3.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e znj. Esmeralda Selita në detyrën e anëtarit të bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 658, datë 6.12.2023**

## PËR AUTORIZIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT PËR NEGOCIMIN DHE NËNSHKRIMIN E RINOVIMIT TË MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT STRATEGJIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË "*MICROSOFT CORPORATION*"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "d", të nenit 31, të ligjit nr. 43/2023, "Për qeverisjen elektronike", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për negocimin dhe nënshkrimin e rinovimit të marrëveshjes së partneritetit strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë "*Microsoft Corporation*".

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 659, datë 6.12.2023**

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 141, DATË 22.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 7, të nenit 10, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 141, datë 22.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", të ndryshuar, pika 6/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6/2. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga 2 (dy) zëvendësdrejtorë të përgjithshëm, të caktuar nga drejtorët e emëruar të drejtorive të përmbajtjes së Autoritetit, të cilët, krahas detyrave funksionale, kryejnë çdo detyrë tjetër të caktuar nga drejtori i përgjithshëm për ta mbështetur atë në mbarëvajtjen e institucionit.".

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 660, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 236, DATË 14.4.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË KOPSHTIT PUBLIK DHE TË GODINËS SË BASHKISË VORË, BASHKIA VORË DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 236, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Vorë, për vitin 2023, i transferohet fondi, në masën 31 895 387 (tridhjetë e një milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

b) Në pikën 3 , fjalët "... , sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ..." zëvendësohen me "... , sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 661, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 279, DATË 12.5.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT SOCIAL-KULTUROR, PALLATI I KULTURËS, BASHKIA SHIJAK, DHE CAKTIMIN E BASHKISË SHIJAK SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/2, të vendimit nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, nga fondet e rindërtimit, miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar në masën 111 821 603 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 662, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 359, DATË 16.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË URËS NË LEZHË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 359, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Lezhë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në masën 78 879 186 (shtatëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 663, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 360, DATË 16.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË DY OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË RROGOZHINË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË RROGOZHINË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 360, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, në masën 139 982 993 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, të ndarë, si më poshtë vijon:

a) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare "Qamil Gjuzi", Bashkia Rrogozhinë, në masën 1 477 033 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare "Lekaj", Bashkia Rrogozhinë, në masën 138 505 960 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e pesëqind e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

dhe Bashkia Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 664, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 391, DATË 9.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR SISTEMIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE BRENDA ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN SI NJËSI ZBATUESE TË BASHKISË KAMZË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 391, datë 9.6.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, në masën 124 643 653 (njëqind e njëzet e katër milionë e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për sistemimin e hapësirave publike brenda zonës së re për zhvillim, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 665, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 491, DATË 21.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË QENDRAVE SHËNDETËSORE NË BASHKINË KURBIN, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 491, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi për financimin e rikonstruksionit të qendrës shëndetësore në qytetin e Laçit,

Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, në masën 53 118 160 (pesëdhjetë e tre milionë e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.";

b) Në pikën 3 fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2.1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 666, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 499, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NJËSIA ADMINISTRATIVE LAÇ DHE MAMURRAS, BASHKIA KURBIN, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 499, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 153 170 752 (njëqind e pesëdhjetë e tre milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, për rindërtimin në truallin ekzistues të 3 (tri) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 667, datë 6.12.2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM DHE RINDËRTIM NË TË NJËJTIN TRUALL", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikat 5 dhe 5.1, të vendimit nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, vlera "1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë)

lekë" ndryshon dhe bëhet "3 102 823 839 (tre miliardë e njëqind e dy milionë e tetëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 668, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 90, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT TË GODINËS KOPSHT/ÇERDHE NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 90, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Mirditë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 58 467 571 (pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, për ndërtimin e godinës kopsht/çerdhe në zonën e re për zhvillim, njësia administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 669, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 89, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË GODINAVE, SPITALI 'SHENJTA MARI' DHE DREJTORIA E SHËNDETIT PUBLIK (ISH-SPITALI INFEKTIV), NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE" , TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 89, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Mirditë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 250 611 639 (dyqind e pesëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali "Shenjta Mari" dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-spitali infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, që do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 670, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 87, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT/ RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË MIRDITË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 87, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 69 904 472 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit/riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 671, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 88, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË TRI OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KURBIN DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 88, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 177 869 644 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH, që do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) 61 380 329 (gjashtëdhjetë e një milionë e treqind e tetëdhjetë mijë e treqind e njëzet e nëntë) lekë për rikonstruksionin e gjimnazit "At'Shtjefen "Kurti"";

b) 42 706 254 (dyzet e dy milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë për rikonstruksionin e kopshtit nr. 3 Laç;

c) 73 783 061 (shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare "Nike Tom Prela".".

b) Në pikën 3, fjalët "... e pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... e pikave 1, 2 dhe 2/1...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 672, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 27, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË DHE KURBIN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 27, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, në masën 574 119 996 (pesëqind e shtatëdhjetë e katër milionë e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 218 675 601 (dyqind e tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 355 444 395 (treqind e pesëdhjetë e pesë milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e treqind e

nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë e Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 673, datë 6.12.2023

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 645, DATË 3.8.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA ‘5 MAJI’, DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE 6, ZONA ‘KOMBINAT’, BASHKIA TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.2, të vendimit nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.3, me këtë përmbajtje:

“2.3. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, në masën 3 430 228 255 (tre miliardë e katërqind e tridhjetë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji” dhe njësinë administrative 6, zona “Kombinat” në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 674, datë 6.12.2023

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 715, DATË 24.11.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT E TË RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS DHE MIRDITË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 715, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, në masën 182 334 343 (njëqind e tetëdhjetë e dy milionë e treqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Tiranë, i cili i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 675, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 980, DATË 2.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIMIT, ZBATIMIT TË PUNIMEVE, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE DHE ADMINISTRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 980, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, për financimin e projektimit, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë pa TVSH, dhe të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 676, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 770, DATË 15.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE 'DEMOKRACIA', VALIAS I RI, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 770, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 207 216 918 (dyqind e shtatë milionë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 677, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 428, DATË 8.7.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KURBIN DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 428, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Kurbin, për vitin 2023, i transferohet fondi, në masën 181 980 074 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Milot, Bashkia Kurbin, në masën 107 610 825 (njëqind e shtatë milionë e gjashtëqind e dhjetë mijë e tetëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH;

b) Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Milot", Bashkia Kurbin, në masën 74 369 249 (shtatëdhjetë e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzet e nëntë ) lekë pa TVSH.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 678, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 500, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJË OBJEKTI ARSIMOR NË BASHKINË VORË DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të

Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 500, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në masën 129 974 554 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, shkolla e mesme "Isa Boletini", Bashkia Vorë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2.1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 679, datë 6.12.2023

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 490, DATË 21.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT DHE RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË MIRDITË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i" e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 490, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, nga Bashkia Mirditë, në masën 146 888 754 (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit dhe riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 680, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 714, DATË 24.11.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE 'HALIT COKA', BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 714, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Halit Coka", Bashkia Kamzë, në masën 309 893 727,32 (treqind e nëntë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë presje tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2.1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 681, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 239, DATË 20.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË KAVAJË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 239, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, nga Bashkia Kavajë, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, në masën 713 796 227 (shtatëqind e trembëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kavajë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 682, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 255, DATË 29.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) NË BASHKINË DURRËS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendës-kryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 255, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, në masën 1 216 066 129 (një miliard e dyqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, nga Bashkia Durrës, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 683, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3.4, të vendimit nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.5, me këtë përmbajtje:

"3.5 Përveç përcaktimeve të pikës 3.4 të këtij vendimi, fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit të 2023, do të jetë në masën 528 451 028 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e njëzet e tetë) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 305 255 685 (treqind e pesë milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë;

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi prej 223 195 343 (dyqind e njëzet e tre milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e tre) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim në Bashkinë Tiranë.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 684, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 122, DATË 2.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE 'PICAR', BASHKIA VORË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 122, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 94 872 000 (nëntëdhjetë e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të shkollës 9-vjeçare "Picar", Bashkia Vorë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.";

b) Në pikën 3 fjalët "... sipas pikave 1, 2 dhe 2.1 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 685, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 169, DATË 17.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE TË ISH-REPARTIT 'RENEA', DREJTORIA E FORCËS SË POSAÇME OPERACIONALE, LINZË, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe

ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 169, datë 17.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi në masën 131 876 398 (njëqind e tridhjetë e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve të ish-repartit "RENEA", Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 686, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.4, të vendimit nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.5, me këtë përmbajtje:

"2.5. Përveç përcaktimeve të pikës 2.4, të këtij vendimi, fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2023, do të jetë në masën 1 662 450 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili do t'i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 687, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 206, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË STACIONIT TË ZJARRFIKËSES DHE TË GODINËS SË BORDIT TË KULLIMIT, BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 206, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në masën 168 314 290 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e treqind e katërmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për rindërtimin e stacionit të zjarrfikëses, Bashkia Kavajë, në vlerën 62 340 125 (gjashtëdhjetë e dy milionë e treqind e dyzet mijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, në vlerën 105 974 165 (njëqind e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 688, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.3, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.4, me këtë përmbajtje:

"2.4 Përveç përcaktimeve të pikës 2.3, të këtij vendimi, fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2023, të jetë në masën 124 350 534 (njëqind e njëzet e katër milionë e treqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 10 174 823 (dhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekësh pa TVSH;

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 114 175 711 (njëqind e katërmbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 689, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1134, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/ RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË TIRANË DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, në masën 176 394 915 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore (RSU nr. 1 (nr. 15–18–19) nr. 20–21; nr. 22–23", në RSU nr. 1, shkolla "Dritas", në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar, përkatësisht, sipas detajimit të mëposhtëm, për:

a) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 15), në vlerën 143 361 593 (njëqind e dyzet e tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH;

b) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 19), në vlerën 10 544 343 (dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë e treqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH;

c) rikonstruksionin e godinave nr. 20–21, nr. 22–23, në vlerën 22 488 979 (njëzet e dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 690, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 181, DATË 30.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, në masën 1 994 584 758 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe u transferohet bashkive Durrës, Lezhë dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) për Bashkinë Durrës, në masën 1 490 187 768 (një miliard e katërqind e nëntëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

b) për Bashkinë Lezhë, në masën 107 654 732 (njëqind e shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH;

c) për Bashkinë Krujë, në masën 396 742 258 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Durrës, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 691, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 166, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 166, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2023, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 553 165 340 (pesëqind e pesëdhjetë e tre milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.";

b) Në pikën 3 fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 692, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 180, DATË 30.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E PËRGATITJES SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT NË BASHKINË KRUJË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii" e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 180, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, për financimin e shembjeve të njësive individuale të banimit të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre në Bashkinë Krujë, në masën 58 482 812 (pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, që përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 693, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 200, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË MIRDITË DHE KAMZË, DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/3, të vendimit nr. 200, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/4, me këtë përmbajtje:

"2/4. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, nga Bashkia Kamzë, për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari", Zall Mner, Bashkia Kamzë, në masën 221 999 677 (dyqind e njëzet e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 694, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 215, DATË 31.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË LEZHË E KURBIN, DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 215, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, në masën 237 208 329,42 (dyqind e tridhjetë e shtatë milionë e dyqind e tetë mijë e treqind e njëzet e nëntë presje dyzet e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kurbin në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 695, datë 6.12.2023**

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 125, DATË 3.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTEVE 'REHABILITIMI I LUMIT GJANICË', 'RIKONCEPTIMI I QENDRËS SË QYTETIT' DHE 'NDËRTIMI I STADIUMIT TË LOJËRAVE ME DORË', FIER"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 125, datë 3.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, vlera "...124 395 382 (njëqind e njëzet e katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë ..." zëvendësohet me "...132 334 474 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e treqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë ...";

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 132 334 474 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e treqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh të përballohet:

a) 27 088 361 (njëzet e shtatë milionë e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, nga buxheti i Bashkisë Fier;

b) 97 307 021 (nëntëdhjetë e shtatë milionë e treqind e shtatë mijë e njëzet e një) lekë, nga shpenzimet e miratuara në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm" të programit "Planifikimi urban" në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2022;

c) 7 939 092 (shtatë milionë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë, nga buxheti i shtetit, llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.".

c) Të dhënat e pasurive me nr. 11/18, nr. 11/318, nr. 1/122 ND + 11/12, nr. 11/37+1-1, nr. 11/37+1-2, zona kadastrale 8531, që përkojnë me nënndarjet me numrat rendorë 16, 17, 18, 21 dhe 22, si dhe të dhënat e nënndarjes "shuma totale", të tabelës bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat e tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Fier.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, si dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

TABELA PËR NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE NË LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, BASHKËLIDHUR VENDIMIT NR. 125, DATË 3.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTEVE 'REHABILITIMI I LUMIT GJANICË', 'RIKONCEPTIMI I QENDRËS SË QYTETIT' DHE 'NDËRTIMI I STADIUMIT TË LOJËRAVE ME DORË', FIER"

| Nr. | Nr. rendor në VKM-në nr. 125, datë 3.3.2021 | Emër Atësi Mbiemër | Zona kadastrale | Nr. pasurie | Sipërfaqe shpronësimi | | | Çmimi | | Vlera e tokës truall (lek) | Vlera e banesës (lek) | Vlera e objektit të shërbimit në (leë) | Vlera totale (lek) | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Tokë truall ($m^2$) | Sip. banimi ($m^2$) | Sip. e objektit të shërbimit ($m^2$) | Tokë truall ($m^2$) | Banesë/ $m^2$ | | | | | |
| 1 | **16** | Sami Bajram Kanaj | 8531 | 11/18 | 445.7 | 260 | | 12458 | 52,062 | 5,552,531 | 13,536,060 | | 19,088,590.80 | Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier. |
| 2 | **17** | Kadri Bajram Kanaj | 8531 | 11/318 | 314.1 | 252.8 | | 12458 | 52,062 | 3,913,058 | 13,161,215 | | 17,074,273.26 | Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier. |
| 3 | **18** | Fatmir Faslli Mylka | 8531 | 11/122 ND+11/122 | 380 | 120 | | 12458 | 52,062 | 4,734,040 | 6,247,412 | | 10,981,452.40 | Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier. Sipas shkresës së ASHK Fier, datë 7.2.2022, protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 1305, datë 15.2.2022. Kjo pasuri është e llojit "truall" dhe është certifikuar me sipërfaqe 500 $m^2$, data e lëshimit të certifikatës 16.2.2021. |
| 4 | **21** | Ferik Idriz Shabanaj, Bele Imer Shabanaj | 8531 | 11/37+1-1 | 18.94 | 52.56 | | 12458 | 52,062 | 235,955 | 2,736,367 | | 2,972,321.15 | Konfirmuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Fier. Sipas kartelës të datës 30.5.2022, kjo pasuri ka sipërfaqe truall prej 71.5 $m^2$. |
| 5 | **22** | Arben Refat Laze, Fatbardha Suri Laze | 8531 | 11/37+1-2 | 18.9 | 61.02 | | 12458 | 52,062 | 235,456 | 3,176,809 | | 3,412,265.41 | Konfirmuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Fier. Sipas kartelës së pasurisë datë 30.5.2022, kjo pasuri ka sipërfaqe truall prej 79.92 $m^2$. |
| **VLERA TOTALE** | | | | | | | | | | | | | **132 334 474** | |

*** Efekti financiar shtesë në VKM-në nr. 125, datë 3.3.2021 është 7,939,092 lekë.**

**VENDIM**
**Nr. 696, datë 6.12.2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 820, DATË 21.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS, TË KATEGORIVE, TË KUSHTEVE, TË KËRKESAVE TË KUALIFIKIMIT DHE TË EKSPERIENCËS PROFESIONALE PËR PERSONIN, TË CILIT I LËSHOHET CERTIFIKATA NË VEPRIMTARINË STUDIMORE PROJEKTUESE NË FUSHËN MINERARE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 33, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e zëvendës-kryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 820, datë 21.10.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, fjalët:

a) "Aplikanti për këtë certifikatë duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare ..." zëvendësohen me "Kërkuesi për këtë certifikatë duhet të paraqesë nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*" ...";

b) "... jo më pak se 2 (dy) referenca vlerësuese ..." zëvendësohen me "... jo më pak se 1 (një) referencë vlerësuese ...";

c) "… kërkesën për kategorinë e certifikatës" hiqen.

2. Në pikën 5 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në nënndarjen A.1, shkronja "ç" shfuqizohet;

b) Në nënndarjen A.2 bëhen këto ndryshime:

i. shkronjat "d" dhe "e" shfuqizohen;

ii. në shkronjën "c", fjalët "... jo më pak se 3 (tre) vjet" zëvendësohen me "... jo më pak se 2 (dy) vjet".

c) Në nënndarjen A.3, shkronjat "d" dhe "dh" shfuqizohen;

ç) Në nënndarjen A.4, shkronjat "ç" dhe "dh" shfuqizohen;

d) Në nënndarjen A.5, shkronjat "d" dhe "e" shfuqizohen;

dh) Në nënndarjen A.6, shkronjat "d" dhe "e" shfuqizohen;

e) Në nënndarjen A.7, shkronjat "d" dhe "e", shfuqizohen;

ë) Në nënndarjen B.1, shkronja "ç" shfuqizohet;

f) Në nënndarjen B.2, shkronja "ç" shfuqizohet;

g) Në nënndarjen B.3, shkronja "ç" shfuqizohet;

gj) Në nënndarjen B.4, shkronja "ç" shfuqizohet;

h) Në nënndarjen B.5 bëhen këto ndryshime:

i. shkronjat "d" dhe "e" shfuqizohen;

ii. në shkronjën "c", fjalët "... jo më pak se 3 (tre) vjet" zëvendësohen me "... jo më pak se 2 (dy) vjet".

i) Në nënndarjen B.6, shkronjat "d" dhe "e" shfuqizohen;

j) Në nënndarjen B.7, shkronjat "d" dhe "e" shfuqizohen;

k) Në nënndarjen B.8, bëhen këto ndryshime:

i. në fjalinë e parë, fjalët "... në nëntokë" hiqen;

ii. shkronjat "d" dhe "dh" shfuqizohen.

l) Në nënndarjen B.9 bëhen këto ndryshime:

i. në fjalinë e parë, fjalët "... me karrierë" zëvendësohen me "... në sipërfaqe";

ii. në shkronjën "b", pas nënndarjes " - dëftesë e shkollës së mesme për teknikët e minierave", shtohet " - certifikatë profesionale e nivelit IV ose V në fushën gjeologji – miniera";

iii. shkronjat "d" dhe "dh" shfuqizohen;

iv. në paragrafin e fundit, fjalët "... jo më shumë se 5 000 tonë/m³ në vit", zëvendësohen me "... jo më shumë se 150 000 tonë ose m³ në vit".

ll) Në nënndarjen B.10, shkronjat "d" dhe "dh" shfuqizohen.

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Kushtet e punësimit për drejtuesit teknikë në veprimtarinë minerare të shfrytëzimit.".

4. Pas pikës 9 shtohen pikat 9.1, 9.2 e 9.3, me këtë përmbajtje:

"9.1 Individët e pajisur me certifikatën e drejtuesit teknik sipas pikës B.8:

a) lejohen të jenë të punësuar si drejtues teknikë vetëm në një zonë të lejuar minerare, me kapacitet prodhimi vjetor mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) tonë, kur veprimtaria kryhet në nëntokë, dhe me kapacitetet prodhimi vjetor mbi 200 000 (dyqind mijë) tonë, kur veprimtaria kryhet në sipërfaqe;

b) lejohen të jenë të punësuar si drejtues teknikë deri në katër zona të lejuara minerare, kur veprimtaria kryhet në nëntokë dhe zonat janë të

mbivendosura vertikalisht. Kapaciteti total i prodhimit vjetor të zonave së bashku të jetë nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) tonë;

c) lejohen të jenë të punësuar si drejtues teknikë në tri zona të lejuara minerare, me kusht që kapaciteti total i prodhimit vjetor të zonave së bashku të jetë nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) tonë, kur veprimtaria kryhet në nëntokë, dhe me kusht që kapaciteti total i prodhimit vjetor të zonave së bashku të jetë nën 200 000 (dyqind mijë) tonë, kur veprimtaria kryhet në sipërfaqe.

Distanca ndërmjet zonave minerare, ku punohet nën tokë nuk duhet të jetë më e madhe se 10 km, ndërsa distanca ndërmjet zonave minerare, ku punohet në sipërfaqe nuk duhet të jetë më e madhe se 50 km.

9.2 Individët e pajisur me certifikatën sipas pikës B9 lejohen të jenë të punësuar si drejtues teknikë deri në tri zona të lejuara minerare, me kusht që prodhimi vjetor për secilën zonë minerare të jetë nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) tonë.

Distanca ndërmjet zonave minerare nuk duhet të jetë më e madhe se 50 km.

9.3 Individët e punësuar si drejtues teknikë në një zonë të lejuar minerare, ku punohet me regjim gazi, nuk lejohen të jenë të punësuar në zona të tjera minerare, pavarësisht kapacitetit vjetor të prodhimit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 697, datë 6.12.2023**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS RAJONALE TË INOVACIONIT TË INSTITUTIT EVROPIAN TË TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT PËR LËNDËT E PARA (*EIT RAWMATERIALS REGIONAL INOVATION CENTER*)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT RawMaterials Regional Inovation Center*) (në vijim “Qendra”), si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për minierat dhe industrinë (në vijim “ministri”), me seli në Elbasan.

2. Qendra financohet nga:

a) buxheti i shtetit;

b) donacione të subjekteve fizike dhe/ose juridike, nga sektori privat, vendas dhe/ose i huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

c) burime nga palë të treta, të destinuara për programin e veprimeve të Qendrës nga fonde të institucioneve ndërkombëtare të shteteve të veçanta dhe të organizatave të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Qendra ka si mision koordinimin e veprimtarisë lidhur me inovacionin dhe zhvillimin në sektorin e lëndëve të para, në bashkëpunim me Institutin Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (në vijim “*EIT RawMaterials*”).

4. Qendra e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie:

a) mbështetja e koordinimit në nivel kombëtar e rajonal për menaxhimin efektiv të burimeve të lëndëve të para minerare dhe përpunimit të tyre;

b) nxitja e rritjes së inovacionit në sektorin e lëndëve të para;

c) ofrimi i trajnimit dhe mendësisë sipërmarrëse për arsimin e lartë, arsimin profesional, për të mundësuar përgatitjen e një stafi të kualifikuar për këtë sektor dhe duke kufizuar largimin e të rinjve nga vendi;

ç) nxitja e zhvillimit të bizneseve, forcimi i industrisë nxjerrëse dhe përpunuese në Shqipëri, futja e teknologjive të gjelbra, sigurimi i licencës sociale për të vepruar, me qëllim rritjen e furnizimit me lëndë të parë nga Shqipëria në tregun evropian.

5. Qendra e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin vendas dhe bazuar në standardet e përcaktuara nga *EIT RawMaterials* për *RIS HUB*, nëpërmjet grupit ndërinstitucional të punës, i cili funksionon si një platformë katërpalëshe për sektorin e lëndëve të para, me përfaqësues nga institucionet shtetërore përkatëse, shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në industri, bota akademike dhe shoqëria civile. Përbërja, detyrat e grupit të punës dhe masa e shpërblimit të tij përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

6. Standardet teknike, mënyra e operimit dhe e raportimit përcaktohen në bashkëpunim me *EIT RawMaterials*, ndërsa veprimtaria administrative e qendrës mbikëqyret, rregullohet dhe miratohet nga ministria përgjegjëse, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË QENDRËS

1. Qendra ka përgjegjësitë funksionale të organizojë punën:

a) për promovimin e veprimtarisë në fushën minerare dhe të industrisë;

b) për nxitjen e bashkëpunimit mes aktorëve të helikës së katërfishtë (qeverisje qendrore dhe vendore, akademi, biznes dhe shoqëri civile) në fushën e lëndëve të para;

c) për të kontribuuar në krijimin e kurrikulave të përshtatshme për arsimin e lartë dhe arsimin profesional dhe edukimin gjatë gjithë jetës e ofrimin e trajnimeve dhe mundësive për të përgatitur staf të kualifikuar për sektorin, si dhe promovimin e sektorit të lëndëve të para;

ç) për të kontribuuar në thithjen e trurit dhe parandalimin e largimit të tij;

d) për të kontribuuar në fuqizimin dhe modernizimin e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të lëndëve të para;

dh) për të kontribuuar në prezantimin e teknologjisë së gjelbër dhe zhvillimin e sektorit, me qëllim rritjen e furnizimit me burime të para nga Shqipëria për tregun evropian;

e) për të lehtësuar sigurimin e fondeve në nivel rajonal në mbështetje të aktiviteteve të sipërcituara.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS

1. Qendra e ushtron dhe e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror. Qendra mund ta shtrijë aktivitetin edhe në nivel rajonal.

2. Qendra drejtohet nga drejtuesi i saj, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e saj, përfaqëson qendrën në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet përpara ministrit.

3. Drejtuesi i Qendrës emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri. Drejtuesi i Qendrës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar apo i huaj, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të huajt;

b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit 7 të Kornizës Shqiptare apo Evropiane të Kualifikimeve në fusha studimi që lidhen me shkencat sociale, inxhinierike, juridike, ekonomike;

ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet, ku 5 (pesë) prej tyre në fushën e ekspertizës dhe/apo të administrimit publik;

d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

4. Drejtuesi i Qendrës shkarkohet nga detyra kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

b) kryen shkelje të rënda gjatë detyrës;

c) nuk përmbush objektivat strategjikë të institucionit;

ç) ka performancë të dobët në ushtrimin e detyrës.

5. Drejtuesi i Qendrës lirohet nga detyra kur:

a) plotëson kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

c) ristrukturohet institucioni;

ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;

d) jep dorëheqjen nga detyra.

6. Marrëdhëniet e punës së drejtuesit të Qendrës, nëpunësve dhe punonjësve administrativë mund të jenë me kohë të plotë ose të pjesshme dhe rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Qendra punëson pranë strukturave të saj staf ekspertësh teknikë me eksperiencë në fushën e lëndëve të para në sektorin publik, privat apo akademik, të cilët përzgjidhen në bazë të kritereve teknike të përcaktuara apo sipas karakteristikave të projekteve që do të menaxhohen, në bashkëpunim me *EIT RawMaterials*.

7. Përveç stafit teknik të përhershëm, Qendra kur e sheh të arsyeshme, për të realizuar misionin dhe objektivat e saj, mund të angazhojë specialistë të jashtëm, me kontratë shërbimi.

8. Qendra, në zbatim të misionit, fushave të përgjegjësisë dhe përgjegjësive funksionale të saj, kryen këto detyra:

a) ngre strukturën e nevojshme në mbështetje të programit të veprimtarive të bashkërenduara me *EIT RawMaterials*;

b) përgatit objektivat e planit të punës në bashkëpunim me komitetin ndërinstitucional dhe ministrinë e linjës;

c) përgatit raportet vjetore për aktivitetin e Qendrës, si dhe i publikon e shpërndan ato;

ç) përgatit raportet për *EIT RawMaterials* dhe ministrin;

d) vlerëson dhe kontribuon në rishikimin e bazës ligjore për të reflektuar në legjislacionin përkatës kërkesat e standardit global *EIT RawMaterials*, si dhe për të evidentuar pengesat e ndryshme për zbatimin e tij;

dh) identifikon burime të qëndrueshme të financimit për zbatimin e planit kombëtar, si dhe i monitoron ato;

e) ndjek një strategji komunikimi dhe informimi, në bashkëpunim me *EIT RawMaterials* dhe ministrinë përgjegjëse;

ë) ndërmerr veprimet e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve/trajnimin e punonjësve të helikës së katërfishtë, ku përfshihet edhe media, si dhe grupeve të interesit të lidhura me sektorin e lëndëve të para;

f) ndërmerr veprimet e nevojshme për trajnimin e punonjësve të Qendrës, në përputhje me programin dhe objektivat e përcaktuara në bashkëpunim me *EIT RawMaterials*;

g) raporton para grupit ndërinstitucional të punës, në mënyrë periodike, për ecurinë e realizimit të veprimtarive të programit;

gj) koordinon veprimtarinë e inovacionit dhe zhvillimit të industrive të lëndëve të para dhe materialeve;

h) evidenton dhe realizon projekte të ndryshme që lidhen me fushën e lëndëve të para;

i) identifikon nevojat dhe prioritizimin për sektorët e industrive, me qëllim për të mbështetur zhvillimin e tyre në standardet më të mira dhe asistencës në aplikimet për projekte dhe iniciativa;

j) ndërmerr veprimet e nevojshme për rritjen e ndërgjegjësimit të operatorëve, institucioneve dhe organizatave shqiptare dhe për inkurajimin e pjesëmarrjes të tyre në aktivitetet *EIT RawMaterials* përmes organizimit të eventeve të përbashkëta, të fokusuar në sektorin e lëndëve të para në Shqipëri;

k) ndërmerr veprimet e nevojshme për promovimin e iniciativave, sipas sektorëve nëpërmjet organizimit të aktiviteteve, shkencore, *workshop*-eve, seminareve dhe takimeve të niveleve të ndryshme;

l) ndërmerr aktivitete të përbashkëta me *EIT RawMaterials* për të nxitur sipërmarrjen dhe aftësitë sipërmarrëse dhe inovative midis specialistëve, studentëve dhe promovimin e arsimit STEM (shkenca, teknologji, inxhinieri, matematikë) për të zhvilluar aftësitë për të ardhmen për nevojat e industrisë së lëndëve të para në Shqipëri dhe potencialisht në rajon;

ll) jep asistencë për arritjen e standardeve më të larta, teknike, teknologjike, të sigurisë dhe të operimit në industrinë e lëndëve të para;

m) zhvillon dhe forcon bashkëpunimin ndërmjet *EIT RawMaterials* dhe ekosistemeve shqiptare të inovacionit, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit për të kontribuar në krijimin e një brezi të ri sipërmarrësish dhe novatorësh shqiptarë në sektorin e lëndëve të para në Shqipëri, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve shqiptarë në aktivitetet e komunitetit të *EIT RawMaterials*;

n) ndërmerr veprimet e nevojshme për sigurimin e ekosistemit shqiptar të inovacionit me informacionin përkatës për aktivitetet aktuale dhe të ardhshme të *EIT RawMaterials* dhe mundësitë e tjera të sektorit të lëndëve të para;

nj) nxit dhe mbështet inovacionin në çdo industri, promovimin dhe implementimin e metodave tacite dhe implicite, tipike për ekonominë, bazë e të cilave janë bizneset e vogla dhe të mesme në të gjithë vendin dhe në rajon, koordinimin e këtyre veprimtarive me qendrat VET dhe të tjera institute dhe institucione të edukimit profesional në vend dhe në rajon;

o) ndërmerr veprimet e nevojshme për lehtësimin e integrimit të aktiviteteve në vend dhe rajon për të gjitha programet e *EIT RawMaterials*;

p) promovon dhe shpërndan informacione rreth vizionit dhe misionit të *EIT RawMaterials*;

q) mbikëqyr projektet e *EIT RawMaterials RIS Hub*, sipas standardeve të *EIT RawMaterials*, për menaxhimin dhe raportimin në mënyrë profesionale;

r) harton dhe administron një plani veprimi dhe krijon regjistrin/ bazën e të dhënave;

rr) evidenton detyrimet apo nevojat që burojnë nga zbatimi i SKZHI-së, strategjisë për specializimin inteligjent (S3) dhe strategjive të tjera sektoriale e ndërsektoriale, si dhe mbështet ministrinë ose institucionet e tjera përgjegjëse, në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë;

s) ndërmerr veprimet e nevojshme për shkëmbimin e ndërsjellë në kohë të informacionit, eksplorimin e sinergjive dhe komplementariteteve të duhura midis aktiviteteve të *EIT RawMaterials* dhe programeve dhe nismave kombëtare shqiptare, duke përfshirë gjithashtu programet dhe iniciativat e zonës së Ballkanit Perëndimor, si instrumenti për paraanëtarësimin dhe financimet e mundshme nga fonde kombëtare, rajonale ose të BE-së për sektorin e lëndëve të para;

sh) çdo detyrë tjetër në përputhje me misionin, fushat e përgjegjësive dhe përgjegjësitë funksionale të saj.

9. Qendra raporton në çdo mbledhje të grupit ndërinstitucional të punës dhe çdo vit, në mënyrë periodike, përgatit informacion me shkrim për Kryeministrin për ecurinë e realizimit të programit të veprimeve dhe të raportit vjetor.

10. Qendra, për të realizuar misionin dhe objektivat e saj, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me grupin ndërinstitucional të punës, *EIT RawMaterials* dhe me institucione të tjera, publike dhe/ose private, me grupet e interesit, shoqërinë civile, akademinë, median vendase dhe/ose të huaj.

11. Struktura dhe organika e qendrës miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

12. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të qendrës miratohet nga ministri, me propozimin e drejtuesit të qendrës. Pjesë e kësaj rregulloreje janë edhe funksionimi i grupit ndërinstitucional të punës.

13. Qendra ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e qendrës përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Qendra Rajonale e Inovacionit e Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

14. Vula e Qendrës ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare.

15. Qendra mund të përdorë si shtesë dhe logon dhe markën e *EIT RawMaterials*, duke respektuar linjat guidë të *EIT RawMaterials* për përdorimin e tyre. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Qendra Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT RawMaterials Regional Inovation Center*) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 698, datë 6.12.2023**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit "Lista e OKB-së", që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

1. Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohen katër individë të renditur në shkronjën "a", sipas shtesave që i bashkëlidhen këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

2. Në listën e shkronjës "D", të titulluar "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", shtohet kompania e renditur në shkronjën "a", sipas shtesave që i bashkëlidhen këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT**
SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
("LISTA E OKB-së")

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (*DA'ESH*) DHE *AL-QAIDA***

**a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida":**

*1. MOHAMED: AMIN: MOSTAFA;*
*2. SAID JAN: 'ABD AL-SALAM;*
*3. IYAD: AG GHALI;*
*4. ABU MOHAMMED: AL-JAWLANI.*

**D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN *AL-QAIDA***

**a) Lista e shtuar në "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën *Al-Qaida*"**

*1. MAKHTAB AL-KHIDAMAT*

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**VENDIM**
**Nr. 699, datë 6.12.2023**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2, e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 18, të kreut I, pas fjalëve "... (CFSP) 2023/1502 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/2422 ... ";

2. Në aneksin 18, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/2422, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

AL
seritë L

2023/2422 27.10.2023

**VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2023/2422**
**i datës 26 tetor 2023**
**mbi ndryshimin e Vendimit 2013/184/CFSP në lidhje me masat kufizuese në funksion të situatës në Myanmar/Burma**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë,

Duke marrë në konsideratë se:

(1) Më 22 prill 2013, Këshilli miratoi Vendimin 2013/184/CFSP ([1]).

(2) Në lidhje me hyrjen 84 në seksionin A dhe hyrjen 17 në seksionin B në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve që ju nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2013/184/CFSP, masat në nenet 5(1) dhe 6(1) i atij Vendimi zbatohen deri më 29 tetor 2023.

(3) Në bazë të një rishikimi të ndërmjetëm të Vendimit 2013/184/CFSP, masat kufizuese në lidhje me këto dy hyrje duhet të zgjaten deri më 30 prill 2024.

(4) Bazuar në informacionin e përditësuar të marrë, këto dy hyrje dhe shënimi për një person tjetër të përfshirë në Aneksin e Vendimit 2013/184/CFSP duhet të ndryshohen.

(5) Prandaj Vendimi 2013/184/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

*Neni 1*

Vendimi 2013/184/CFSP ndryshohet si më poshtë:

(1) Neni 12 zëvendësohet si vijon:

'Neni 12

Ky Vendim do të zbatohet deri më 30 Prill 2024. Ai do të mbahet në shqyrtim të vazhdueshëm. Ai do të rinovohet ose ndryshohet si të jetë e përshtatshme, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.';

(2) Aneksi ndryshohet në përputhje me aneksin e këtij vendimi.

*Neni 2*

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian

([1]) Vendimi i Këshillit 2013/184/CFSP i 22 prillit 2013 në lidhje me masat kufizuese në funksion të situatës në Myanmar/Burma (OJ L 111, 23.4.2013, f. 75).

Në Bruksel, më 26 tetor 2023.

*Për Këshillin*
*Presidenti*
P. NAVARRO RÍOS



*ANEKS*

Aneksi i Vendimit 2013/184/CFSP ("Lista e personave, subjekteve dhe organeve fizike dhe juridike të përmendura në nenet 5(1) dhe 6(1)") është ndryshuar si më poshtë:

(1) në seksionin 'A. Personat fizikë të përmendur në nenet 5 pika 1 dhe 6 pika 1", shënimet 84 dhe 93 zëvendësohen me sa vijon:

| | Emri | Informacion identifikues | Arsyet | Data e listimit |
|---|---|---|---|---|
| '84. | Naing Htut Aung | Kombësia: Myanmar/Burma;<br>Datëlindja: 27.1.1968;<br>Gjinia: mashkull<br>Numri i pasaportës: 12/MAKAYA 118765 | Naing Htut Aung është drejtor dhe aksioner i vetëm i International Gateways Group of Company Limited (IGGC) që operon në sektorin tregtar. Ai ka lidhje të forta me udhëheqjen ushtarake në Mianmar.<br>Nëpërmjet IGGC, Naing Htut Aung ofroi mbështetje financiare për Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) në 2017 në një ngjarje për mbledhjen e fondeve në lidhje me Rakhine 'clearance operations', dhe ia dhuroi Tatmadaw në 2023 me rastin e Ditës së Forcave të Armatosura. Për më tepër, Naing Htut Aung u identifikua si një importues dhe ndërmjetësues i armëve, pajisjeve ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë për Tatmadaw, të cilat u përdorën kundër popullsisë civile dhe protestuesve në të gjithë vendin.<br>Duke kontribuar në aftësitë e ushtrisë për të kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe shtypjen e popullatës civile, si dhe për të kryer aktivitete që minojnë demokracinë dhe sundimin e ligjit në Myanmar/Burma, Naing Htut Aung ofroi mbështetje për Tatmadaw dhe u angazhua në veprime që kërcënojnë paqen, sigurinë ose stabilitetin e Myanmar/Burma-s. | 8.11.2022'; |
| '93. | Myo Myint Oo | Kombësia: Myanmar/Burma;<br>Vendi i lindjes:<br>Myanmar/Burma;<br>Gjinia: mashkull | Myo Myint Oo është Ministër i Unionit për Energjinë që nga 5 gushti 2022. Si Ministër i Qeverisë, ai është pjesë e regjimit ushtarak.<br>Nën autoritetin e tij, entiteti i listuar në BE Myanmar Oil and Gas Enterprise (MOGE) gjeneron të ardhura për Këshillin e Administratës Shtetërore të listuar në BE (SAC) dhe Myanmar Petroleum Enterprise, e cila është e angazhuar në importin dhe shpërndarjen e karburantit të aviacionit, përfshirë për avionët gjuajtës dhe avionë të tjerë ushtarakë.<br>Si Ministër i Energjisë, ai është i ngarkuar për të mundësuar investimet dhe bashkëpunimin me partnerët e huaj në sektorët e naftës dhe gazit, që krijon të ardhura për SAC, duke kontribuar kështu në sigurimin e nevojave financiare të regjimit ushtarak dhe në importimin e karburantit të aviacionit për ushtrinë e cila mundëson sulmet ajrore ushtarake kundër civilëve.<br>Prandaj, ai është një person fizik, veprimet, politikat ose aktivitetet e të cilit minojnë demokracinë ose sundimin e ligjit në Myanmar/Burma, ose që angazhohet ose ofron mbështetje për veprime që kërcënojnë paqen, sigurinë ose stabilitetin e Myanmar/Burma. | 20.2.2023'; |

(1) në seksionin 'B. Personat fizikë dhe juridikë, subjektet dhe organet të përmendur në nenin 6(1)', pika 17 janë zëvendësuar si më poshtë:

| | Emri | Informacion identifikues | Arsyet | Data e listimit |
|---|---|---|---|---|
| '17. | International Gateways Group of Company Limited (a.k.a. IGGC, a.k.a. IGG) | Adresa: Kyaik Wine Pagoda Road, Nr 19, Myaing Hay Wun Housing, 8-Mile, Mayangone, Yangon, Myanmar;<br>ose<br>Rruga Thamadi Nr 4-1/3, Lagjja e 8-të, Township Mayangone, rajoni Yangon, Myanmar;<br>Email: internationalgatewaysho@gmail.com;<br>Vendi i regjistrimit: Myanmar;<br>Individi i lidhur: Naing Htut Aung (Drejtor dhe aksioner i vetëm)<br>Subjekti i lidhur: MEHL | International Gateways Group of Company Limited (IGGC) është një kompani e bashkëdrejtuar nga Naing Htut Aung e cila operon në sektorin tregtar. Ajo kontribuoi me fonde si donatore e vetme më e madhe për Forcat e Armatosura të Mianmarit (Tatmadaw) në vitin 2017, në ngjarjet e mbledhjes së fondeve për Rakhine 'clearance operations' të mbajtura nga Komandanti i Përgjithshëm Min Aung Hlaing. Për më tepër, IGGC bëri një donacion për Tatmadaw në 2023 me rastin e Ditës së Forcave të Armatosura. Më tej, IGGC është përfshirë në prokurimin e armëve për Tatmadaw, duke përfshirë pajisje ushtarake dhe mallra me përdorim të dyfishtë, të cilat u përdorën kundër popullsisë civile dhe protestuesve në të gjithë vendin. Prandaj, IGGC ka ofruar mbështetje për Tatmadaw dhe është angazhuar në veprime që kërcënojnë paqen, sigurinë ose stabilitetin e Myanmar/Burma. | 20.2.2023'. |

Official Journal
of the European Union

EN
L series

2023/2422 27.10.2023

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2023/2422**

**of 26 October 2023**

**amending Decision 2013/184/CFSP concerning restrictive measures in view of the situation in Myanmar/Burma**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 22 April 2013, the Council adopted Decision 2013/184/CFSP [1].

(2) With regard to entry 84 in Section A and entry 17 in Section B in the list of natural and legal persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision 2013/184/CFSP, the measures in Articles 5(1) and 6(1) of that Decision apply until 29 October 2023.

(3) On the basis of an interim review of Decision 2013/184/CFSP, the restrictive measures concerning those two entries should be prolonged until 30 April 2024.

(4) Based on the updated information received, those two entries and the entry for one other person included in the Annex to Decision 2013/184/CFSP should be amended.

(5) Decision 2013/184/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

Decision 2013/184/CFSP is amended as follows:

(1) Article 12 is replaced by the following:

'*Article 12*

This Decision shall apply until 30 April 2024. It shall be kept under constant review. It shall be renewed, or amended as appropriate, if the Council deems that its objectives have not been met.';

(2) the Annex is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

---

[1] Council Decision 2013/184/CFSP of 22 April 2013 concerning restrictive measures in view of the situation in Myanmar/Burma (OJ L 111, 23.4.2013, p. 75).

Done at Brussels, 26 October 2023.

*For the Council*
*The President*
P. NAVARRO RÍOS



ANNEX

The Annex to Decision 2013/184/CFSP ('List of natural and legal persons, entities and bodies referred to in Articles 5(1) and 6(1)') is amended as follows:

(1) in Section 'A. Natural persons referred to in Articles 5(1) and 6(1)', entries 84 and 93 are replaced by the following:

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| '84. | Naing Htut Aung | Nationality: Myanmar/Burma;<br>Date of birth: 27.1.1968;<br>Gender: male<br>Passport number: 12/MAKAYA 118765 | Naing Htut Aung is a Director and sole shareholder of International Gateways Group of Company Limited (IGGC) operating in the trading sector. He has strong ties with the military leadership in Myanmar.<br>Through IGGC, Naing Htut Aung provided financial support to the Myanmar Armed Forces (Tatmadaw) in 2017 at a fundraising event in connection with the Rakhine 'clearance operations', and donated to the Tatmadaw in 2023 on the occasion of the Armed Forces Day. Additionally, Naing Htut Aung was identified as an importer and broker of arms, military equipment and dual-use goods for the Tatmadaw, which were used against the civilian population and protesters all across the country.<br>By contributing to the military's capabilities to commit serious human rights violations and the repression of the civilian population, as well as to carry out activities undermining democracy and the rule of law in Myanmar/Burma, Naing Htut Aung provided support to the Tatmadaw and engaged in actions that threaten the peace, security or stability of Myanmar/Burma. | 8.11.2022'; |
| '93. | Myo Myint Oo | Nationality: Myanmar/Burma;<br>Place of birth: Myanmar/Burma;<br>Gender: male | Myo Myint Oo has been the Union Minister for Energy since 5 August 2022. As Government Minister, he forms part of the military regime.<br>Under his authority, EU-listed entity Myanmar Oil and Gas Enterprise (MOGE) generates revenue for the EU-listed State Administration Council (SAC) and Myanmar Petroleum Enterprise, which is engaged in the import and distribution of aviation fuel including for fighter jets and other military aircraft.<br>As Minister for Energy, he is in charge of enabling the investment and cooperation with foreign partners in the oil and gas sectors, which creates revenue for the SAC, thereby contributing to securing the financial needs of the military regime and to importing aviation fuel for the military which enables the military airstrikes against civilians.<br>He is therefore a natural person whose actions, policies or activities undermine democracy or the rule of law in Myanmar/Burma, or who engages in, or provides support for, actions that threaten the peace, security or stability of Myanmar/Burma. | 20.2.2023'; |

(2) in section 'B. Legal persons, entities and bodies referred to in Article 6(1)', entry 17 is replaced by the following:

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| '17. | International Gateways Group of Company Limited (a.k.a. IGGC, a.k.a. IGG) | Address: Kyaik Wine Pagoda Road, No 19, Myaing Hay Wun Housing, 8-Mile, Mayangone, Yangon, Myanmar;<br>or<br>Thamadi Street No 4-1/3, 8th Quarter, Mayangone Township, Yangon region, Myanmar;<br>Email: internationalgatewaysho@gmail.com;<br>Place of registration: Myanmar;<br>Associated individual: Naing Htut Aung (Director and sole shareholder)<br>Associated entity: MEHL | International Gateways Group of Company Limited (IGGC) is a company co-directed by Naing Htut Aung and which operates in the trading sector. It contributed funds as the single largest donor to the Myanmar Armed Forces (Tatmadaw) in 2017, at fundraising events for the Rakhine 'clearance operations' held by Commander in Chief Min Aung Hlaing. In addition, IGGC donated to the Tatmadaw in 2023 on the occasion of the Armed Forces Day. Furthermore, IGGC has been involved in arms procurement for the Tatmadaw, including military equipment and dual-use goods, which were used against the civilian population and protesters all across the country. IGGC has therefore provided support to the Tatmadaw and engaged in actions that threaten the peace, security or stability of Myanmar/Burma. | 20.2.2023'. |

**VENDIM**
**Nr. 701, datë 6.12.2023**

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 569, DATË 6.10.2023, "PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR TË VITIT 2023 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË SAMITIT TË PROCESIT TË BERLINIT TË DATËS 16 TETOR 2023"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936/2016, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 569, datë 10.10.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në titull, pas fjalëve "... 16 tetor 2023 ..." shtohen "... dhe të Samitit të III të Diasporës, në datat 22–23 nëntor 2023 ...".

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi prej 51 000 000 (pesëdhjetë e një milionë) lekësh, përkatësisht, si më poshtë vijon:

a) 42 000 000 (dyzet e dy milionë) lekë për përballimin e shpenzimeve të organizimit në Tiranë të Samitit të Procesit të Berlinit, në datën 16 tetor 2023;

b) 9 000 000 (nëntë milionë) lekë për përballimin e shpenzimeve të organizimit në Tiranë të Samitit III të Diasporës, në datat 22–23 nëntor 2023.".

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 702, datë 6.12.2023**

## PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2024, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2024, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 71 217 100 (shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind) lekë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)
ANEKSI NR. 1

**Plani i shpenzimeve për vitin 2024**

| Nr. | **Emërtimi i shpenzimeve** | **Viti 2024 (lekë)** |
|---|---|---|
| 1 | Pagat dhe shtesat e tjera | 47 252 500 |
| 2 | Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 7 507 600 |
| 3 | Shërbime e furniturë | 13 957 000 |
| 4 | Investime | 2 500 000 |
| | **TOTALI** | **71 217 100** |

**VENDIM**
**Nr. 703, datë 6.12.2023**

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË KOLEGJIT UNIVERSITAR "PAVARËSIA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "l", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së kolegjit universitar "Pavarësia", i cili e ka ushtruar veprimtarinë në qytetin e Vlorës.

2. Kolegji universitar "Pavarësia" ka këto detyrime:

a) të përgatisë dosjen për çdo student që nuk ka përfunduar programin përkatës të studimit, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë, që plotëson kriteret ligjore për transferimin e studimeve dhe t'ia vërë atë në dispozicion vetë studentit, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

b) të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj studentit;

c) të mbyllë të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore në të gjitha ciklet e studimit ku ushtron veprimtarinë dhe për të gjitha programet e studimit të ofruara;

ç) të dorëzojë dokumentacionin ligjor, administrativ, financiar dhe akademik që disponon dhe mbi bazën e të cilit ka zhvilluar veprimtarinë e saj akademike dhe kërkimore-shkencore në strukturat përgjegjëse, në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat, brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

d) të vendosë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

dh) të marrë masa që të heqë nga objekti i veprimtarisë së personit juridik në institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

3. Vula e kolegjit universitar "Pavarësia" të asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

4. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e kolegjit universitar "Pavarësia", në zbatim të këtij vendimi, të përballohen nga ana e institucionit jopublik të arsimit të lartë/personit juridik privat që e përfaqëson.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe kolegji universitar "Pavarësia" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 704, datë 6.12.2023**

**PËR FINANCIMIN E VEPRIMTARISË SË FONDACIONIT "*DURRAH CITY FOOTBALL ACADEMY*" PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 2, dhe 19, pika 4, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në buxhetin e vitit 2023, në programin buxhetor 08140 "Për zhvillimin e sportit", në llogarinë ekonomike 604 "Transferta të brendshme", të përdoret për financimin e shpenzimeve të ushtrimit të

veprimtarisë së fondacionit "*Durrah City Football Academy*".

2. Fondi i përcaktuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e fondacionit, në bankën e nivelit të dytë.

3. Fondacioni "*Durrah City Football Academy*", brenda muajit shkurt 2024, të dërgojë zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raportin e shpenzimeve të realizuara për vitin 2023, të miratuara nga Bordi Drejtues i fondacionit.

4. Fondet buxhetore, që do t'i akordohen fondacionit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duhet t'i nënshtrohen rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 705, datë 6.12.2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 893, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT 'EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA', NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, pika 1, dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", dhe të aktit normativ nr. 5, datë 18.10.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022, 'Për buxhetin e vitit 2023'", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Financimin, në masën 600 000 000 (gjashtëqind milionë) lekë, të projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të ndarë:

a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;

b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023.".

b) Në pikën 2, pas fjalëve "... për vitin 2022 ..." shtohen "... dhe buxheti i miratuar për vitin 2023 ...".

c) Në pikën 3, pas fjalëve "... brenda muajit janar 2023 ..." shtohen "... dhe brenda muajit shkurt 2024, përkatësisht për financimet sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij vendimi ...".

ç) Fjalia e dytë, e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Brenda muajit shkurt 2024 të depozitohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raporti vjetor i veprimtarisë së projektit "Ekipet sportive në shkolla", përfshirë raportimin financiar.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 706, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 569, DATË 17.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KOMPETENCAVE, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e

administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4/1, të kreut III/1, të vendimit nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4/2, me këtë përmbajtje:

"4/2. Përjashtimisht, për sezonin turistik të vitit 2024, shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare sigurohet vetëm për bashkitë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë, Sarandë, Lezhë dhe Shkodër, sipas hartave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.".

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe bashkitë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë, Sarandë, Lezhë dhe Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**




CURRILA-KALLM
BASHKIA DURRËS
Sip. 81,760 m2
Gjatësia 1,260 m/linear
Distanca nga deti në tokë 100 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
4578000
4577000
452000
451000


CURRILA
BASHKIA DURRËS
Sip. 140,000 m2
Gjatësia 1,720 m/linear
Distanca nga deti në tokë 100 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.125 0.25 0.5 Km
4576000
452600
451600



PLAZHI I MADH
BASHKIA DURRËS
Sip. 1,728,830 m2
Gjatësia 6,880 m/linear
Distanca nga deti në tokë 470 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.425 0.85 1.7 Km
Arapaj
Shkallnur
4575600
4570600
460600
455600


4449000
4448000
466060
465060
464060
PALASË
BASHKIA HIMARË
Sip. 544,655 m2
Gjatësia 840 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,900 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.125 0.25 0.5 Km


DHËRMI-DRIMADHË
BASHKIA HIMARË
Sip. 973,860 m²
Gjatësia 5,360 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,130 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.25 0.5 1 Km
Dhërmi
Gjilekë
4447000
4446000
4445000
465600
466600
467600
468600
469600


JALË
BASHKIA HIMARË
Sip. 164,700 m2
Gjatësia 865 m/linear
Distanca nga deti në tokë 350 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.075 0.15 0.3 Km
4443000
4442500
475100
474600
474100


LIVADH
BASHKIA HIMARË
Sip. 183,920 m2
Gjatësia 1,280 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,310 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.125 0.25 0.5 Km
4442000
4441000
477600
476600
475600


HIMARË
HIMARË QYTET
Sip. 133,520 m2
Gjatësia 1,920 m/linear
Distanca nga deti në tokë 170 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
4440500
4440000
479600
479100
478600
478100


LLAMAN
BASHKIA HIMARË
Sip. 33,500 m2
Gjatësia 190 m/linear
Distanca nga deti në tokë 580 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
N
4439000
4438500
4438000
480600
480100
479600
479100


QEPARO
BASHKIA HIMARË
Sip. 93,200 m²
Gjatësia 1,640 m/linear
Distanca nga deti në tokë 440 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
N
4435500
4435000
485600
485100
484600
484100



BORSH
BASHKIA HIMARË
Sip. 422,620 m2
Gjatësia 4,660 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,960 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.35 0.7 1.4 Km
Borsh
Qazim Pali
Qeparo Fushë
4435000
490600
485600


4430000
491600
490600
BUNEC
BASHKIA HIMARË
Sip. 99,670 m2
Gjatësia 1,035 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,080 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.075 0.15 0.3 Km



LUKOVË
BASHKIA HIMARË
Sip. 218,530 m²
Gjatësia 1,260 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,200 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.175 0.35 0.7 Km
N
4428000
4427000
493600
492600
491600
490600


GOLEM-QERRET
BASHKIA KAVAJË
Sip. 3,490,160 m²
Gjatësia 6,730 m/linear
Distanca nga deti në tokë 730 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.5 1 2 Km
N
Golem
Qeret
Kryemëdhej
Tilaj
Agonas
4567000
460600
455600


KARPEN
BASHKIA KAVAJË
Sip. 183,000 m2
Gjatësia 1,300 m/linear
Distanca nga deti në tokë 185 m
Karpen i ri
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.1 0.2 0.4 Km
N
4561000
455600
456600


SARANDË QYTET
(PLLAKAT)
BASHKIA SARANDË
Sip. 255,205 $m^2$
Gjatësia 1,800 m/linear
Distanca nga deti në tokë 250 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0
0.1
0.2
0.4 Km
N
4416000
4415000
499600
498600


SARANDË QYTET
BASHKIA SARANDË
Sip. 418,748 m2
Gjatësia 3,000 m/linear
Distanca nga deti në tokë 280 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.25 0.5 1 Km
Metoq
Gjashtë
Çukë
4415000
4414000
4413000
503600
502600
501600
500600
499600


KSAMIL
BASHKIA SARANDË
Sip. 7,890,160 $m^2$
Gjatësia 7,890 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,500 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0
0.5
1
2 Km
N
Çukë
Dritas
Vurgu i Ri
4412000
4407000
505600
500600
495600


KSAMIL 1
BASHKIA SARANDË
Sip. 1,989,766 m2
Gjatësia 2,200 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1,400 m
Ksamil
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.175 0.35 0.7 Km
4405000
4404000
4403000
500600
499600
498600


SPILLE
BASHKIA RROGOZHINË
Sip. 1,829,005 m2
Gjatësia 7,880 m/linear
Distanca nga deti në tokë 380 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0
0.5
1
2 Km
Stërbeg
Shardushk
Spanesh
Spille
Patkë-Milot
Rreth-Greth
Vilë-Ballaj
4552000
4547000
455600
450600


AKERNI
BASHKIA VLORË
Sip. 813,636 m2
Gjatësia 2,640 m/linear
Distanca nga deti në tokë 300 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.2 0.4 0.8 Km
4492000
4491000
448600
447600
446600
445600


ZVËRNEC
BASHKIA VLORË
Sip. 439,941 m2
Gjatësia 2,500 m/linear
Distanca nga deti në tokë 300 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.15 0.3 0.6 Km
4485000
4484000
451600
450600
449600


ZVËRNEC 1
BASHKIA VLORË
Sip. 1,504,170 m2
Gjatësia 4,800 m/linear
Distanca nga deti në tokë 700 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.275 0.55 1.1 Km
N
Nartë
4485000
4484000
4483000
4482000
449600
450600
451600
452600
453600


PLAZHI I VJETËR
BASHKIA VLORË
Sip. 666,202 m2
Gjatësia 2,800 m/linear
Distanca nga deti në tokë 360 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.15 0.3 0.6 Km
4482000
4481000
4480000
455600
454600
453600


LONGOMARE-UJI I FTOHTË
BASHKIA VLORË
Sip. 998,868 m2
Gjatësia 4,385 m/linear
Distanca nga deti në tokë 295 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.375 0.75 1.5 Km
Kaninë
4480000
4479000
4478000
4477000
4476000
453600
454600
455600
456600
457600
458600
459600


RADHIMË-ORIKUM
BASHKIA VLORË
Sip. 2,301,621 m2
Gjatësia 10,800 m/linear
Distanca nga deti në tokë 580 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.75 1.5 3 Km
N
Radhimë
Tragjas
4472000
4467000
455600
450600
445600


BASHKIA SHKODËR
PLAZHI VELIPOJË
Sip. 2910844 m
Gjatësia 3800 m/linear
Distanca nga deti në tokë 3600 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0
0.5
1
2 Km
N
Velipojë
Pulaj
Pulaj
4639000
4637000
455000
453000
451000
449000


BASHKIA SHKODËR
PLAZHI BAKS-RRJOLL
Sip. 270853 m2
Gjatësia 1300 m/linear
Distanca nga deti në tokë 900 m
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.125 0.25 0.5 Km
N
Baks-Rrjoll
4636000
4635000
457000
456000
455000


BASHKIA LEZHË
PLAZHI RRJOLLIT
Sip. 206900 m2
Gjatësia 1900 m/linear
Distanca nga deti në tokë 100 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0 0.125 0.25 0.5 Km
4634000
4633000
462000
461000
460000


BASHKIA LEZHË
PLAZHI RANA E HEDHUN
Sip. 790612 m2
Gjatësia 4700 m/linear
Distanca nga deti në tokë 1200 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0
0.5
1
2 Km
Mali-Shëngjin
4633000
4632000
4631000
4630000
462000
463000
464000
465000
466000


BASHKIA LEZHË
PLAZHI SHËNGJIN
Sip. 1983188 m2
Gjatësia 4900 m/linear
Distanca nga deti në tokë 2500 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0
0.5
1
2 Km
Balldren i Ri
Ishull-Shëngjin
Ishull-Lezhë
4630000
4628000
4626000
463000
465000
467000
469000



BASHKIA LEZHË
PLAZHI TALE
Sip. 1930877 m2
Gjatësia 4200 m/linear
Distanca nga deti në tokë 3000 m
N
Legjenda
Zona të propozuara për pastrim
Sistemi koordinativ: KRGJSH
0
0.5
1
2 Km
Grykë-Lumi
Tale 1
4620000
4618000
463000
465000
467000

| Bashkia | Vendndodhje | Sipërfaqja (m²) | Gjatësia (m/linear) | Gjerësia (m) | Fillim i Plazhit (Veri) | | Mbarim i Plazhit (Jug) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Koordinata E | Koordinata N | Koordinata E | Koordinata N |
| Durrës | Gjiri i Lalzit | 5,275,880 | 6,730 | 640-930 | 459151.21 | 4600734.80 | 459676.09 | 4594050.09 |
| | Currila-Kallm | 81,760 | 1,260 | 30-100 | 451429.89 | 4578075.84 | 451548.54 | 4576832.95 |
| | Currila | 140,000 | 1,720 | 30-100 | 451855.71 | 4576719.11 | 452677.86 | 4575257.30 |
| | Plazhi i Madh | 1,728,830 | 6,880 | 120-470 | 455699.27 | 4575812.64 | 459887.15 | 4570390.09 |
| Himarë | Palasë | 544,655 | 840 | 176-1900 | 466229.79 | 4449130.53 | 464869.13 | 4447984.61 |
| | Dhërmi–Drimadhe | 973,860 | 5,360 | 205-1130 | 465725.44 | 4447453.95 | 470001.74 | 4444538.52 |
| | Jalë | 164,700 | 865 | 150-350 | 474530.63 | 4443288.51 | 474700.49 | 4442547.28 |
| | Livadh | 183,920 | 1,280 | 80-1,310 | 476663.07 | 4442413.17 | 477032.01 | 4441020.93 |
| | Himarë | 133,520 | 1,920 | 55-170 | 478025.69 | 4440818.93 | 479058.27 | 4439577.59 |
| | Llaman | 33,500 | 190 | 70-580 | 480145.48 | 4439057.13 | 480188.04 | 4438402.52 |
| | Qeparo | 93,200 | 1,640 | 52-440 | 485056.50 | 4435833.35 | 484017.53 | 4435248.32 |
| | Borsh | 422,620 | 4,660 | 100-1,960 | 487222.29 | 4436658.44 | 489363.83 | 4432238.60 |
| | Bunec | 99,670 | 1,035 | 120-1,080 | 490505.93 | 4430346.48 | 490904.76 | 4429442.18 |
| | Lukovë | 218,530 | 1,260 | 80-1,200 | 492726.91 | 4428340.45 | 492605.63 | 4426203.34 |
| Kavajë | Golem–Qerret | 3,490,160 | 6,730 | 380-730 | 459576.01 | 4570519.13 | 458072.53 | 4564194.15 |
| | Karpen | 183,000 | 1,300 | 84-185 | 456520.79 | 4561580.95 | 455870.81 | 4560420.93 |
| Sarandë | Qytet (Pllakat) | 255,205 | 1,800 | 30-250 | 498587.10 | 4415988.70 | 500061.78 | 4414869.19 |
| | Qytet | 418,748 | 3,000 | 50-280 | 500827.45 | 4415541.85 | 502198.81 | 4412567.96 |
| | Ksamil | 7,890,160 | 7,890 | 100-1500 | 501761.71 | 4412876.97 | 500703.12 | 4405213.92 |
| | Ksamil1 | 1,989,766 | 2,200 | 1000-1400 | 500586.36 | 4405202.54 | 499788.84 | 4402862.72 |
| Rrogozhinë | Spille | 1,829,005 | 7,880 | 30-380 | 454205.31 | 4553721.43 | 453783.63 | 4546159.69 |
| Vlorë | Akerni | 813,636 | 2,640 | 120-300 | 447007.59 | 4492780.08 | 447577.93 | 4490136.99 |
| | Zvërnec | 439,941 | 2,500 | 80-300 | 449813.47 | 4485536.65 | 451783.83 | 4483565.44 |
| | Zvërnec 1 | 1,504,170 | 4,800 | 45-700 | 450741.05 | 4485435.94 | 454069.38 | 4481959.07 |
| | Plazhi i Vjetër | 666,202 | 2,800 | 125-360 | 454088.68 | 4481980.29 | 455751.74 | 4479990.82 |
| | Lungomare–Uji i Ftohtë | 998,868 | 4,385 | 60-295 | 456449.52 | 4479990.32 | 455945.16 | 4475432.62 |
| | Radhimë–Orikum | 2,301,621 | 10,800 | 50-580 | 455949.32 | 4475419.26 | 451144.61 | 4464795.97 |
| Shkodër | Velipojë | 2,910,844 | 3,800 | 50-3600 | 450529.95 | 4639479.54 | 450131.21 | 4635585.53 |
| | Baks–Rrjoll | 270,853 | 1,300 | 900 | 456029.83 | 4636519.18 | 456643.38 | 4635399.09 |
| Lezhë | Rrjolle | 206,900 | 1,900 | 100 | 460218.09 | 4634146.20 | 461834.32 | 4633053.25 |
| | Rana e Hedhun | 790,612 | 4,700 | 1200 | 461900.04 | 4633073.07 | 465336.62 | 4630549.96 |
| | Shëngjin | 1,983,188 | 4,900 | 2500 | 466169.67 | 4631122.86 | 466437.05 | 4625496.93 |
| | Tale | 1,930,877 | 4,200 | 3000 | 465140.98 | 4620869.78 | 464893.94 | 4616648.38 |

## VENDIM
## Nr. 707, datë 6.12.2023

## PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT TË PROVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 78/2020, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Klevis Qose emërohet drejtor i përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 708, datë 6.12.2023

## PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Granit Gjana, prefekt i Qarkut të Kukësit, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Agron Geca emërohet prefekt i Qarkut të Kukësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**UDHËZIM**
**Nr. 25, datë 1.12.2023**

**PËR PILOTIMIN E SKEMËS SË MËSUESIT NË DISPOZICION DHE DETYRAVE TË TIJ NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 6, të nenit 57, dhe të neneve 26 dhe 60, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) organizon punën me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për pilotimin e skemës së mësuesit në dispozicion dhe përcaktimin e detyrave të tij, për vitin shkollor 2023–2024.

2. ZVA emëron si mësues në dispozicion mësuesit që në fillim të vitit shkollor ngelen pa ngarkesë mësimore; në rast se nuk plotësohen vendet vakante, atëherë përzgjidhen aplikantët nga portali "Mësues për Shqipërinë", duke respektuar udhëzimin në fuqi.

3. ZVAP-ja emëron mësuesit në dispozicion me kontratë pune me afat të caktuar deri në përfundim të vitit shkollor, sipas numrit dhe profileve të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

4. Numri i mësuesve në dispozicion në fazën e pilotimit të skemës dhe institucionet arsimore parauniversitare ku do të punësohen, përcaktohet në aneksin 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

5. Detyrat e mësuesit të dispozicionit përfshijnë dhe detyrat në lidhje me përforcimin për lëndët që do të mbulojnë, sipas nevojave të kërkuara nga institucioni shkollor kur nuk paraqitet nevoja e zëvendësimit (dispozicionit).

KREU II
DETYRAT E MËSUESIT NË DISPOZICION

1. Mësuesi në dispozicion është mësuesi që zëvendëson lëndët mësimore të përcaktuara në aneksin 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, në rastet kur:

a) mungojnë në punë mësues për arsye shëndetësore, të cilët trajtohen me raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme që paguhen nga punëdhënësi;

b) mungojnë në punë mësues me leje administrative, me ose pa të drejtë page, sipas përcaktimeve të nenit 96 të Kodit të Punës dhe të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, që miraton rregullat për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Mësuesi në dispozicion realizon orë përforcimi me nxënësit me arritje të ulëta për lëndët ku zhvillohet përforcimi. Në kontratën e punës përcaktohet institucioni arsimor publik parauniversitar, ku mësuesi në dispozicion do të zhvillojë orët e përforcimit.

3. Mësuesi në dispozicion zbaton orarin mësimor, orarin e përforcimit dhe planin mësimor të miratuar nga drejtoria e institucionit arsimor publik parauniversitar, ku do të realizojë zëvendësimin/përforcimin.

KREU III
NGARKESA MËSIMORE JAVORE DHE REALIZIMI I SAJ

1. Ngarkesa mësimore javore e mësuesit në dispozicion është sa ngarkesa javore e mësuesit të arsimit bazë të profilit/lëndës përkatëse.

2. Drejtoria e institucionit arsimor publik parauniversitar, sapo merr informacion për mungesën në punë të mësuesit, informon ZVAP-në, e cila njofton menjëherë mësuesin në dispozicion për institucionin ku do të paraqitet në punë për zëvendësim. Njoftimi i mësuesit, në rastet kur është e mundur, të bëhet një ditë përpara zëvendësimit.

3. Mësuesi në dispozicion, pas njoftimit të marrë nga ZVAP-ja, komunikon me drejtorinë e institucionit arsimor publik parauniversitar ku do të paraqitet, për t'u informuar për orarin mësimor dhe

temat mësimore, si dhe njofton drejtorinë e institucionit arsimor publik parauniversitar, ku zhvillon orët e përforcimit.

4. Gjatë kohës që mësuesi nuk ka orë në skemën e zëvendësimit, kryen detyra të ngarkuara nga drejtoria e shkollës, që lidhen me përforcimin.

5. Përforcimi në arsimin fillor, për lëndët e përcaktuara në aneksin 3, realizohet me 3 orë në javë gjithsej.

6. Përforcimi në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë për lëndët gjuhë shqipe-letërsi dhe matematikë realizohet me nga 2 orë në javë, ndërsa për lëndët e tjera realizohet me nga 1 orë në javë për secilën prej tyre.

7. Grupet për orët e përforcimit për klasë/klasa paralele për secilën lëndë krijohen sipas rregullave ku një grup mund të ketë nga 10 deri në 25 nxënës.

8. Drejtoria e institucionit arsimor publik parauniversitar cakton grupet e nxënësve dhe harton orarin e orëve të përforcimit që do të zhvillohen në atë institucion për çdo javë mësimore.

9. Në përfundim të çdo muaji, drejtoria e institucionit/institucioneve arsimor/e publik/e parauniversitar/e, ku mësuesi në dispozicion ka kryer orët mësimore të zëvendësimit/orët e përforcimit, dërgon zyrtarisht në ZVAP formularin e mësuesit në dispozicion sipas aneksit 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Një kopje e formularit i dorëzohet edhe mësuesit në dispozicion.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pika 9 e kreut 8/1 të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit "Mësues për Shqipërinë", të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
**Ogerta Manastirliu**

ANEKSI 1
PROFILI I MËSUESIT QË DO TË EMËROJË ZVAP-ja, SIPAS NUMRIT TË MIRATUAR

| Numri i mësuesve të miratuar | Profilet për çdo mësues |
|---|---|
| **1** | Arsim fillor |
| **2** | Arsim fillor; gjuhë shqipe-letërsi |
| **3** | Arsim fillor; gjuhë shqipe-letërsi; matematikë-fizikë |
| **4** | Arsim fillor; gjuhë shqipe-letërsi; matematikë-fizikë; gjuhë e huaj |
| **5** | Arsim fillor; gjuhë shqipe-letërsi; matematikë-fizikë; gjuhë e huaj; biologji-kimi |
| **6** | Arsim fillor; gjuhë shqipe-letërsi; matematikë-fizikë; gjuhë e huaj; biologji-kimi; histori-gjeografi |
| **Më shumë se 6 mësues** | Emërohen sipas rregullit të përcaktuar në këtë aneks. |

ANEKSI 2

**a) Numri i mësuesve në dispozicion sipas ZVAP-së ku do të emërohen**

| Nr. | DRAP | ZVAP | Numri i mësuesve në dispozicion |
|---|---|---|---|
| 1 | Durrës | Dibër | 2 |
| 2 | Durrës | Durrës | 6 |
| 3 | Durrës | Kamzë | 6 |
| 4 | Durrës | Krujë | 2 |
| 5 | Durrës | Tiranë | 20 |
| 6 | Durrës | Vorë | 2 |
| 7 | Fier | Fier | 6 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 8 | Fier | Gjirokastër-Libohovë | 2 |
| 9 | Fier | Lushnjë | 2 |
| 10 | Fier | Sarandë-Delvinë-Konispol | 2 |
| 11 | Fier | Vlorë-Himarë | 6 |
| 12 | Korçë | Berat | 2 |
| 13 | Korçë | Elbasan | 6 |
| 14 | Korçë | Korçë-Pustec | 2 |
| 15 | Korçë | Librazhd | 2 |
| 16 | Korçë | Përrenjas | 2 |
| 17 | Lezhë | Has | 2 |
| 18 | Lezhë | Kukës | 2 |
| 19 | Lezhë | Lezhë | 2 |
| 20 | Lezhë | Shkodër | 6 |
| | | **Gjithsej mësues** | **82** |

**b) Institucionet arsimore ku do të pilotohet përforcimi**

| Nr. | DRAP | ZVAP | Institucioni arsimor | Lloji i IA-së | Numri i nxënësve |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Durrës | Krujë | "Adem Gjeli" | Arsim bazë | 1626 |
| 2 | Durrës | Tiranë | "Kongresi i Manastirit" | Arsim bazë | 1491 |
| 3 | Durrës | Tiranë | "Edith Durham" | Arsim bazë | 1418 |
| 4 | Durrës | Kamzë | "100 Vjetori" | Arsim bazë | 1314 |
| 5 | Durrës | Tiranë | "Vasil Shanto" | Arsim bazë | 1232 |
| 6 | Durrës | Kamzë | "Azem Hajdari" | Arsim bazë | 1230 |
| 7 | Durrës | Tiranë | "Fan S. Noli" | Arsim bazë | 1105 |
| 8 | Durrës | Tiranë | "Emin Duraku" | Arsim bazë | 1077 |
| 9 | Fier | Sarandë-Konispol-Delvinë | "Adem Sheme" | Arsim bazë | 1002 |
| 10 | Fier | Fier | "Andon Xoxa" | Arsim bazë | 974 |
| 11 | Durrës | Durrës | "Qemal Mici" | Arsim bazë | 972 |
| 12 | Korçë | Elbasan | "Luigj Gurakuqi" | Arsim bazë | 949 |
| 13 | Lezhë | Shkodër | "Ismail Qemali" | Arsim bazë | 895 |
| 14 | Durrës | Durrës | "Marie Kaçulini" | Arsim bazë | 882 |
| 15 | Durrës | Dibër | "Selim Alliu" | Arsim bazë | 839 |
| 16 | Fier | Gjirokastër-Libohovë | "Koto Hoxhi" | Arsim bazë | 825 |
| 17 | Fier | Fier | "Naim Frashëri" | Arsim bazë | 815 |
| 18 | Lezhë | Kukës | "Avni Rustemi" | Arsim bazë | 803 |
| 19 | Fier | Vlorë-Himarë | "Ismail Qemali" | Arsim bazë | 799 |
| 20 | Durrës | Vorë | "Vajdin Lamaj" | Arsim bazë | 775 |
| 21 | Lezhë | Has | "Sejdi Dida" | Arsim bazë | 763 |
| 22 | Lezhë | Shkodër | "Ndre Mjeda" | Arsim bazë | 744 |
| 23 | Fier | Vlorë-Himarë | "Jani Minga" | Arsim bazë | 702 |
| 24 | Fier | Lushnje | "Skënder Libohova" | Arsim bazë | 695 |
| 25 | Korçë | Korçë-Pustec | "Sevasti Qirjazi" | Arsim bazë | 693 |
| 26 | Korçë | Elbasan | "Jorgji Dilo" | Arsim bazë | 685 |
| 27 | Lezhë | Lezhë | "Besëlidhja" | Arsim bazë | 664 |
| 28 | Korçë | Përrenjas | "Qybra Sokoli" | Arsim bazë | 637 |
| 29 | Korçë | Librazhd | "Genc Leka" | Arsim bazë | 573 |
| 30 | Korçë | Berat | "22 Tetori" | Arsim bazë | 540 |

## ANEKSI 3
## LËNDËT MËSIMORE QË ZËVENDËSON DHE LËNDËT KU DO TË ZHVILLOJË PËRFORCIM

| Nr. | Profili i mësuesit | Lëndët mësimore që zëvendësojnë | Lëndët ku do të realizohet përforcimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Arsim fillor | Arsimi fillor | Gjuhë shqipe, matematikë të klasave I-V |
| 2 | Gjuhë shqipe - letërsi | Gjuhë shqipe<br>Letërsi<br>Teatër<br>Art pamor<br>Muzikë | Gjuhë shqipe, letërsi |
| 3 | Gjuhë e huaj anglisht | Gjuhë e huaj anglisht<br>Gjuhë të dytë kur e ka të mbrojtur | Gjuhë të huaj anglisht |
| 4 | Matematikë-fizikë | Matematikë<br>Fizikë<br>TIK<br>Aftësim teknologjik | Matematikë, fizikë |
| 5 | Biologji-kimi | Biologji<br>Kimi | Biologji, kimi |
| 6 | Histori-gjeografi | Histori, gjeografi, qytetari, sociologji, filozofi, ekonomi, psikologji | Histori, gjeografi, ekonomi |

## ANEKSI 4
## FORMULARI I MËSUESIT NË DISPOZICION

Institucioni arsimor publik parauniversitar/shkolla____________________
Emri e mbiemri i mësuesit në dispozicion _______________________
Periudha e angazhimit: nga _________________ deri më __________

| Nr. | Profili i mësuesit | Lëndët mësimore që ka realizuar dhe numri i orëve për çdo lëndë | Numri i orëve të përforcimit dhe i orëve të tjera që ka realizuar mësuesi | Numri i orëve të zhvilluara gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| 1. | | | | |

**UDHËZIM**
**Nr. 26, datë 5.12.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 4.11.2022, TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE AFATEVE TË APLIKIMIT, SI DHE TË PROCEDURAVE TË PËRCAKTIMIT TË MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE ATYRE QË NDJEKIN PROGRAME STUDIMI QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR"**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të pikës 6, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 30, datë 4.11.2022, të bëhen ndryshimet, si dhe shtesat më poshtë:

1. Kudo në përmbajtje, ku referohet vendimi nr. 386, datë 1.6.2022, i Këshillit të Ministrave, në fund të shtohet fjala "i ndryshuar".

2. Pika 1, ndryshon si më poshtë:

"1. Studentët, shtetas shqiptarë, që regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2023–2024, e në vijim, aplikojnë për mbështetje financiare sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 386, datë 1.6.2022, të ndryshuar, pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), brenda dy muajve nga data e shpalljes së njoftimit për aplikim.".

3. Shkronja "c", e pikës 2 ndryshon si më poshtë:

"c) Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar.".

4. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

"2/1 Shpërndarja e kuotave për mbështetjen financiare bëhet nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe i njoftohet çdo institucioni publik të arsimit të lartë. Institucionet publike të arsimit të lartë, pas marrjes dijeni për përcaktimin e kuotave, i shpërndajnë ato me vendim të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të pikës 6.1, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.".

5. Pika 3, ndryshon si më poshtë:

"3. Studentët aplikojnë duke depozituar formularin për aplikim.".

6. Pika 5 ndryshon si më poshtë:

"5. Përzgjedhja e studentëve përfitues sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij udhëzimi, bëhet sipas përcaktimeve në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Vendimi i Senatit Akademik për përzgjedhjen e studentëve përfitues, në programet prioritare të studimit, i njoftohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

Pas marrjes së vendimeve të Senateve Akademike të IAL-ve publike, AKFAL-i harton listën përfundimtare dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin. Bazuar në këtë listë, ministria përgjegjëse për arsimin akordon fondin për çdo institucion publik të arsimit të lartë.".

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Arsimit dhe Sportit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
**Ogerta Manastirliu**

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 178
Datë: 2023/12/12 15:46:37
b2c9112d-1ae5-4e89-b2ad-5ef8b5dae8aa

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë